



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
AGJENCIA E SHËRBIMEVE KOMUNALE

Nr. 8698 / 16 Prot.

Divjakë, më 15.08.2025.

PROJEKT - VENDIM

Nr. 58, datë 15.08. 2025

"PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE PËR VITIN 2025-2029".

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 , datë 17.12.2015 “ *Për Vetëqeverisjen Vendore* ”, (i ndryshuar), bazuar në Ligjin nr. 10463, datë 22/09/2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, neni 12 dhe neni 13, Ligjin nr. 10431/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Ligjin nr.8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave", VKM nr. 418/2020, “Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035”, VKM nr. 671/2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, në funksion dhe në përmbushje të kuadrit ligjor mjedisor, VKM nr.418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr.608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr.319, datë 31.05.2018, “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, VKM nr. 402 datë 30.06.2021 "Për miratimin e Katalogut të Mbetjeve", VKM nr. 957 datë 19.12.2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, VKM nr. 452, datë 11.07.2012, ndryshuar me VKM nr. 389, datë 27.6.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 452, datë 11.07.2012 të Këshillit të Ministrave”, VKM nr. 575 datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Divjakë, me datë 27.08.2025:

1. Të miratojë Planin Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve për vitin 2025-2030 sipas dokumentit të planit të bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Agjencia e Shërbimeve Komunale Divjakë.

JURISTI
Andi Bullari

Drejtori I Agjencisë së Shërbimeve Komunale
Çerçis Turhani

KRYETARI
JOSIF GORREA



Përgjegjëse e Financës
Xhenina Alcani